

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6867
E mërkurë, 5 prill 2023
çmimi 0.40 €

Finlanda i bashkohet NATO-s

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AVOKATËT E THAÇIT, TË VESELIT DHE TË SELIMIT PARAQESIN FJALËN HYRËSE
NË PROCESIN GJYQËSOR NË HAGË

FAQE 4-5

MBROJTJA E LIDERËVE TË UÇK-së 'DEMOLON' PRETËNDIMET E ZPS-së

- **Thaçi:** Viktimat nuk marrin drejtësi kur të pafajshmit ndiqen. Një padrejtësi nuk ndreqet nga një padrejtësi tjetër

- **Selimi:** Unë nuk kam frikë nga drejtësia, por nga padrejtësia duhet të kemi frikë të gjithë



Mbrojtja e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit kanë hedhur poshtë të gjitha akuzat ZPS-së në lidhje me udhëheqësit e UÇK-së. Ata kanë deklaruar se Thaçi, Veseli dhe Selimi janë të pafajshëm dhe se pretendimet e prokurorisë mbështeten në të

pavërteta. Në këtë kontekst, mbrojtja e tyre të martën në fjalët hyrëse ka dhënë hollësi se si ka funksionuar UÇK-ja. Para trupit gjykues, Hashim Thaçi i ka mohuar të gjitha akuzat e prokurorisë, duke thënë se viktimat nuk marrin drejtësi kur të

pafajshmit ndiqen. Ai ka thënë se një padrejtësi nuk ndreqet nga një padrejtësi tjetër. Ndërsa Rexhep Selimi ka thënë se nuk ka frikë nga drejtësia, por nga padrejtësia. Të mërkurën fjalën hyrëse do ta paraqesë edhe mbrojtja e Jakup Krasniqit

AMBASADOR ROHDE, PËRMBAJU MISIONIT, NUK JE AS PROKUROR E AS GJYKATËS!

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



VLORA HYSENI MERR DREJTIMIN
E SHËRBIMIT INFORMATIV
SHTETËROR TË SHQIPËRISË F.3

OSMANI MBUSH DY VJET
SI PRESIDENTE F.3

PARAQITET RAPORTIT NJËVJEÇAR
I ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË
SUNDIMIT TË LIGJIT F.6


EKONOMI



GËRXHALIU THOTË SE ISHIN PESË
FAKTORË QË NDIKUAN NË RRRITJEN
E TË HYRAVE TË BRENDSHME
TË ATK-së F.8

EKZEKUTOHET PAGA PËR
500 PUNËTORËT E PARË
TË "SUPERPUNËS" F.8

SPORT



FFK-ja REAGON LIDHUR ME
AKTIVITETET ILEGALE TË KLUBEVE
SERBE NË KOSOVË F.6

Finlanda i bashkohet NATO-s

HELSINKI, 4 PRILL - Finlanda është bërë anëtarja më e re, e 31-ta, e NATO-s, pas mbajtjes së ceremonisë së pranimit në Bruksel të martën, më 4 prill, në atë që sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, e quajti "ditë historike".

Aplikimi për anëtarësimin e Finlandës në aleancën ushtarake është nxitur nga lufta e Rusisë në Ukrainë, e nisur më 24 shkurt 2022.

Finlanda ndan një kufi të gjatë, prej mbi 1 000 kilometrash, me Rusinë. "Putini kishte deklaruar se

qëllimi i pushtimit të Ukrainës [ishite] të kishte më pak NATO, ai donte më pak NATO përgjatë kufijve të tij, donte ta mbyllte derën e NATO-s. Ai po merr pikërisht të kundërtën", tha Stoltenbergu pas anëtarësimit të Finlandës.

Suedia, po ashtu, ka aplikuar për anëtarësim në NATO, në të njëjtën kohë me Finlandën, mirëpo Turqia është duke e bllokuar me arsyetimin se është duke mbështetur "terroristët".

Përmes një deklarate, presidenti i ShBA-së, Joe Biden, tha se "sot

jemi më të bashkuar se kurrë më parë. Dhe së bashku - të forcuar nga aleati ynë më i ri, Finlanda - ne do të vazhdojmë ta ruajmë sigurinë transatlantike, ta mbrojmë çdo pëllëmbë të territorit të NATO-s dhe t'i kalojmë të gjitha sfidat me të cilat përballemi".

Si akt të parë pas anëtarësimit, ministri i Jashtëm finlandez, Pekka Haavisto, ia dorëzoi sekretarit amerikan të Shtetit, Anthony Blinken, ratifikimin e kërkesës së Suedisë për anëtarësim në NATO.



Polonia ia dërgon Ukrainës avionët e parë luftarakë MiG-29



VARSHAVË, 4 PRILL - Polonia tashmë ka transferuar disa nga avionët e saj luftarakë MiG-29 në Ukrainë, pas Sllovakisë e cila më 23 mars njoftoi se dërgoi katër avionët e parë në Kiev. "Disa MiG-29 janë dërguar tashmë. Ata janë vërtet të dobishëm për Ukrainën, në mbrojtjen e sigurisë sonë kolektive", tha ndihmësi i presidentit polak, Marcin Przydacz, për radiostacionin

lokal RMF FM.

Muajin e kaluar Polonia u bë anëtarja e parë e NATO-s që premtoi avionët luftarakë për Ukrainën. Përpara pushtimit të plotë të Rusisë në shkurt të vitit 2022, Ukraina kishte disa dhjetëra MiG-29 që trashëgoi pas rënies së Bashkimit Sovjetik në vitin 1991, por është e paqartë se sa prej tyre mbeten në shërbim pas më shumë se një viti luftimesh. Forca

ajrore e Ukrainës është familjarizuar me MiG-29 dhe mund t'i përdorë avionët menjëherë.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u ka kërkuar vazhdimisht vendeve perëndimore avionë luftarakë, por aleatët e NATO-s janë treguar të përmbytur, duke përmendur shqetësimin për përshkallëzimin e rolit të aleancës në luftë.

Raportohet se balona e spiunimit i ka dërguar Kinës të dhëna në kohë reale

PEKIN, 4 PRILL - Një balonë kineze, që ka fluturuar mbi territorin e Shteteve të Bashkuara javë më parë, ka arritur të mbledhë të dhëna inteligjente nga bazat ushtarake, disa ditë para se të rrëzohej, kanë raportuar mediet amerikane.

Balona ka arritur t'i dërgojë Pekinit të dhëna në kohë reale, ka raportuar rrjeti NBC News, duke cituar zyrtarë amerikanë.

Balona ka pasur qasje në sinjalet elektronike, por nuk ka bërë fotografi, sipas një zyrtari të cituar nga ky rrjet.

Shtëpia e Bardhë nuk i ka

konfirmuar këto raportime.

Mirëpo, një zëdhënës i Shtëpisë së Bardhë ka thënë se ShBA-ja ka arritur t'i kufizojë kapacitetet e balonës për mbledhje të të dhënave të ndjeshme.

Zyrtarët amerikanë kanë thënë se e kanë identifikuar balonën mbi Alaskë dhe Kanada para se të kalonte në hapësirën ajrore amerikane në fillim të muajit shkurt.


Pas disa ditëve të përgjimit dhe spekulimeve, publikut i është bërë me dije se balona është duke fluturuar mbi territorin amerikan.

Balona rreth 60 metra e gjatë është rrëzuar më 4 shkurt nga një aeroplan luftarak amerikan në ujërat e Karolinës Jugore.

Zyrtarët amerikanë kanë thënë se balona ka mbledhur të dhëna për motin dhe se ShBA-ja e ka ekzagjeruar situatën, duke e rrëzuar atë.

Ky incident ka rritur tensionet diplomatike mes dy vendeve dhe e ka detyruar sekretarin amerikan të Shtetit, Antony Blinken, që ta anulojë një udhëtim në Kinë.

Disa javë pas rrëzimit të balonës, aeroplanët luftarakë amerikanë kanë rrëzuar edhe balona të tjera,



që është dyshuar se e kanë origjinën prej Kinës. Departamenti amerikan i

Mbrojtjes ka thënë se Kina operon me një flotë të balonave në botë.

Stoltenbergu: NATO-ja po rrit prodhimin e armëve për ta ndihmuar Ukrainën

BRUKSEL, 4 PRILL - Vendet anëtare të NATO-s po "rrisin" prodhimin e furnizimeve ushtarake për të siguruar që aleanca perëndimore mund të vazhdojë ta mbështesë Ukrainën në luftën e saj kundër pushtimit në shkallë të plotë të Rusisë, tha në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" sekretari i përgjithshëm, Jens Stoltenberg. "Sfida kryesore [me të cilën përballlet NATO] është se kjo luftë tani është kthyer në një luftë shkatërrimi, që do të thotë se beteja logjistike



ka të bëjë me marrjen e municioneve, armëve, furnizimeve në vijat e frontit", ka thënë Stoltenbergu.

Duke folur në selinë e NATO-s në Bruksel përpara takimit ministrave të Jashtëm nga anëtarët e aleancës ushtarake, Stoltenberg tha se në fillim të luftës, e cila nisi në shkurt të vitit 2022, vendet e NATO-s që kërkonin të ndihmonin Kievin duke e furnizuar me armë, "shteronin rezervat tona". "Pra, tani ne po punojmë gjithashtu fort për të rritur prodhimin, kështu që ne mund të sigurojmë se mund të vazhdojmë ta mbështesim Ukrainën, sepse është

jashtëzakonisht e rëndësishme të vazhdojmë ta bëjmë këtë", ka thënë ai.

Stoltenbergu theksoi se do të ishte "një tragjedi për Ukrainën nëse presidenti rus [Vladimir] Putin fiton, por është gjithashtu e rrezikshme për aleatët e NATO-s".

Stoltenberg tha se mesazhi i tij për anëtarët e aleancës ishte: "Ne duhet ta mbështesim Ukrainën sepse është në interesin tonë të sigurisë të tregojmë se Putin [nuk] do të fitojë në Ukrainë".

Osmani mbush dy vjet si presidente

PRISHTINË, 4 PRILL - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, të martën ka shënuar dyvjetorin që nga marrja e detyrës si e para e shtetit. Osmani ka thënë se përgjatë këtyre dy vjetëve gjithmonë i vetmi

udhërrëfyes për punën e saj është vullneti qytetar dhe interesi i Republikës së Kosovës. "Dy vjet si presidente e juaja! Si gjithnjë, i vetmi udhërrëfyes në çdo punë e veprim timin është vullneti

qytetar dhe interesi i Republikës së Kosovës. Kështu do të jetë deri në fund të mandatit. Faleminderit përjetësisht për besimin!", ka shkruar Osmani në "Facebook".



Vlora Hyseni merr drejtimin e Shërbimit Informativ Shtetëror të Shqipërisë



Vlora Hyseni ka punuar disa vjet në Agjencinë Kombëtare të Inteligjencës së Kosovës. Ajo ka qenë drejtoreshë e Marrëdhënieve me Jashtë e më pas zëvendësdrejtoreshë e këtij institucioni nga viti 2019, për t'u shkarkuar më vonë, në mesin e vitit 2021, nga presidentja Osmani. Kryeministri Edi Rama e ka uruar Hysenin për detyrën e re në krye të ShISH-it

"Tiranë - Sapo mbaruar prezantimin në institucion të drejtoreshës së re të Shërbimit Informativ të Shtetit, Vlora Hyseni, e cila u dekretua dje nga presidenti i Republikës. Urime!", ka shkruar Rama.

Shërbimi Informativ Shqiptar ka qëndruar pa kreun e tij për rreth një vit, pasi drejtori Helidon Bendo u largua për një trajnim të gjatë në Shtetet e Bashkuara duke dhënë dorëheqje në dhjetorin e kaluar.

Hyseni ka punuar disa vjet në Agjencinë Kombëtare të Inteligjencës së Kosovës. Ka qenë

drejtoreshë e Marrëdhënieve me Jashtë e më pas zëvendësdrejtoreshë e këtij institucioni nga viti 2019, për t'u shkarkuar më vonë, në mesin e vitit 2021, nga presidentja Osmani. Ky fakt ushqeu një sërë debatesh në Shqipëri dhe përfaqësues të opozitës kërkuan nga presidenti Begaj që të kërkonte informacione për shkaqet e shkarkimit të saj nga drejtimi i shërbimeve sekrete të Kosovës. Nuk është hera e parë që në institucionet e Shqipërisë janë emëruar, deri në nivele të ministrave, zyrtarë nga Kosova.

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 4 PRILL - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka dekretuar emërimin e Vlora Hysenit në krye të Shërbimit Informativ Shtetëror (ShISH). Ish-zëvendësdrejtoresha e Agjencisë Kombëtare të

Inteligjencës së Kosovës, Hyseni, u propozua ta merrte drejtimin e shërbimeve sekrete shqiptare, më shumë se dy javë më parë, nga kryeministri Edi Rama. Më 17 mars, pas takimit me presidentin Begaj, për kandidaturën e Hysenit, kryeministri pati shkruar në "Facebook" se kishte "besim të plotë se përgatitja e spikatur,

eksperiencia e krijuar në vite dhe respekti që zonja Hyseni gëzon në komunitetin ndërkombëtar të inteligjencës, përbëjnë një garanci të plotë për reformimin e mëtejshëm të shërbimit informativ shqiptar".

Rama të martën ka shkruar sërish në "Facebook" për emërimin e Vlora Hysenit në krye të ShISH-i.

UP-ja bën konsultimet online mes studentëve dhe profesorëve

PRISHTINË, 4 PRILL - Universiteti i Prishtinës ka njoftuar se tashmë konsultimet ndërmjet studentëve dhe profesorëve mund të mbahen online. "UP-ja ka shënuar hapin e radhës drejt digjitalizimit të shërbimeve për studentët dhe stafin e tij. Në kuadër të SEMS-it është integruar 'moduli i konsultimeve'. Ky modul

inovativ siguron që studentët të marrin shërbime më të mira, më të qasshme dhe praktike në lidhje me procesin e konsultimeve", ka njoftuar UP-ja. Universiteti i Prishtinës ka theksuar se përmes kësaj mundësie studentët mund të lidhen lehtësisht me profesorët e tyre, t'i

planifikojnë konsultimet dhe të diskutojnë për shqetësimet akademike në mënyrë më efikase. "Kjo qasje bashkëkohore jo vetëm që thjeshton procesin e konsultimeve, por gjithashtu pasuron përvojën e të mësuarit nëse për studentët dhe fakultetet", ka njoftuar UP-ja.



SEMS
Digjitalizohen
konsultimet
profesorë - studentë



AVOKATËT E THAÇIT, TË VESELIT DHE TË SELIMIT PARAQESIN FJALËN HYRËSE NË PROCESIN GJYQËSOR NË HAGË

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së “demolon” pretendimet e ZPS-së

- **Thaçi:** Viktimat nuk marrin drejtësi kur të pafajshmit ndiqen. Një padrejtësi nuk ndreqet nga një padrejtësi tjetër
- **Selimi:** Unë nuk kam frikë nga drejtësia, por nga padrejtësia duhet të kemi frikë të gjithë

Mbrojtja e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit kanë hedhur poshtë të gjitha akuzat ZPS-së në lidhje me udhëheqësit e UÇK-së. Ata kanë deklaruar se Thaçi, Veseli dhe Selimi janë të pafajshëm dhe se pretendimet e prokurorisë mbështeten në të pavërteta. Në këtë kontekst, mbrojtja e tyre të martën në fjalët hyrëse ka dhënë hollësi se si ka funksionuar UÇK-ja. Para trupit gjykues, Hashim Thaçi i ka mohuar të gjitha akuzat e prokurorisë, duke thënë se viktimat nuk marrin drejtësi kur të pafajshmit ndiqen. Ai ka thënë se një padrejtësi nuk ndreqet nga një padrejtësi tjetër. Ndërsa Rexhep Selimi ka thënë se nuk ka frikë nga drejtësia, por nga padrejtësia. Të mërkurën fjalën hyrëse do ta paraqesë edhe mbrojtja e Jakup Krasniqit

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

HAGË, 4 PRILL - Mbrojtja e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit kanë paraqitur të martën fjalën hyrëse në procesin gjyqësor të tyre, ndërsa mbrojtja e Jakup Krasniqit do ta paraqesë sot (e mërkurë) fjalën hyrëse. Ish-presidenti dhe lideri politik i UÇK-së, Hashim Thaçi, ka shprehur qëndrimin e tij para trupit gjykues në lidhje me procesin gjyqësor ndaj tij. Thaçi i

ka mohuar të gjitha akuzat me të cilat ngarkohet nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS). “Viktimat nuk marrin drejtësi kur të pafajshmit ndiqen. Një padrejtësi nuk ndreqet nga një padrejtësi tjetër. Unë jam i pafajshëm për të gjitha këto akuzat. Por, unë jam gati të përballim me këtë sfidë të re dhe të kem sukses për familjen time, për popullin tim dhe vendin tim. Rruga jonë drejt lirisë ishte e gjatë dhe shumë e vështirë. Unë isha student në Zvicër, i strehuar

politik kur u masakrua familja Jashari në mars të vitit 1998. Si shumë shqiptarë nga diaspora, edhe unë u ktheva për ta ndihmuar vendin tim dhe iu bashkova rezistencës për lirinë e Kosovës. Kushdo që do të ishte në vendin tonë do të kishte bërë të njëjtën gjë kur t'i hiqej liria”, ka thënë Thaçi. Thaçi ka folur edhe për raportin e Diçk Martyt mbi bazën e të cilit është formuar Gjykata Speciale. “Kur raporti i Dick Martyt, para 13 vjetësh, mbushi titujt e medieve

ndërkombëtare me akuzat të sajara për trafikim organesh nga UÇK-ja dhe nga unë, unë menjëherë i kërkova bashkësisë ndërkombëtare të hetonte në mënyrë të pavarur. Bashkësia ndërkombëtare më tha se një gjykatë e veçantë ishte parësore për të hequr rënë e zezë të akuzave për trafik të organeve në Kosovë. Bota sot e di, se si rezultat i këtij procesi nuk kishte trafikim të organeve dhe se ‘Shtëpia e Verdhë’ nuk ka ekzistuar kurrë. Tani e dimë se edhe unë edhe UÇK-ja edhe populli i Kosovës dhe të gjithë shqiptarët jemi shfajësuar nga këto akuzat. E vërteta është thënë dhe reja e zezë mbi Kosovën është hequr. Pra kjo sakrificë ia ka vlejtur. Unë pres që të shfajësohem nga çdo akuzë tjetër ndaj meje në përfundim të këtij procesi”, ka thënë Thaçi. Paraprakisht avokati i Thaçit, Gregory Kehoe, ka thënë se të hënën Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka tentuar të lidhë dokumente dhe komunikata për të dëshmuar se

“kolaboracionistët ishin kërcënim ekzistencialë”. “Përfaqësuesit e ZPS-së folën si kolaboracionistët, shiheshin si rrezik ekzistencialë. I vetmi rrezik ishte ushtria serbe bashkë me forcat paramilitare”, ka thënë ai. Kehoe ka thënë se Hashim Thaçi akuzohet se ka drejtuar një “ndërmarrje të përbashkët kriminale”, por ka dhënë një shembull se si komandantët lokalë kishin ndryshuar komandantin e përgjithshëm të UÇK-së në kohën kur Thaçi ishte në Rambuje të Francës për t'i dhënë fund luftës në Kosovë. “Komandantët lokalë e ndryshuan komandantin e përgjithshëm, pa marrë mendim nga Thaçi e Azem Sylja, që gjendeshin në Rambuje. Pushteti ishte në dorën e nivelit lokal”, ka thënë avokati Kehoe, duke shtuar se Thaçi nuk ka pasur motiv t'i kryejë krimet për të cilat akuzohet nga ZPS-ja. “Ai e dinte se sukcesi i UÇK-së varej nga mbështetja ndërkombëtare, sidomos nga ShBA-ja”, ka thënë ai, duke

Ishte një dëshmitar që kishte pretenduar se e ka parë Veselin në Kukës duke marrë në intervistë një të ndaluar. Por, ishte e dukshme që në fillim dhe pasi pamë deklaratat e dëshmitë e tij, se ky dëshmitar ishte gabuar sa i përket identifikimit të Veselit dhe ai kështu ishte shprehur edhe vetë. ZPS-ja tani e pranon se ky dëshmitar e ka identifikuar gabimisht Veselin. Qëndrimi i ZPS-së është se është e panevojshme ta ndryshojë aktakuzën për këtë gjë. Ajo nuk propozon që të paraqesë prova në mbështetje të kësaj, ka thënë avokati Ben Emmerson. Sipas Emmersonit, nuk ka asnjë provë që Veseli, si shef i zbulimit, “ka autorizuar apo nxitur ndonjë krim apo vepër kriminale, apo të ketë marrë ndonjëherë ndonjë raportim për kryerjen e ndonjë krimi”.

Emmersoni ka përshkruar rolin e klientit të tij brenda strukturave të UÇK-së si shef i shërbimit sekret. “Sapo Veseli u emërua shef i zbulimit ai u largua nga Kosova deri pak para momentit që NATO ta marrë vendimin për bombardime”, ka thënë ai. Sipas avokatit, funksioni i zbulimit që kryente Veseli ishte i fokusuar në lidhjet e mbajtura me aparatit informativ të Shqipërisë dhe disa shteteve të NATO-s në pritje të asaj që pritej të vinte, përkatësisht fushata e bombardimeve. “Funksioni i tij nuk kishte të bënte fare me zbulimin e brendshëm apo gjetjen e kolaboracionistëve. Fokusi i tij ishte thujse tërësisht me mbajtjen e lidhjes me organizatat e huaja”, ka thënë Emmersoni.

Ai ka përsëritur disa herë se Veseli kishte qëndruar jashtë Kosovës dhe nuk ishte në vendet ku prokuroria pretendon se janë kryer krime në qendrat e ndalimit. Avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka thënë se Zyra e Prokurorit të Specializuar në ditën e parë të gjyqimit mbështeti provat e saj në dokumentet rregullatore të UÇK-së, duke u

mbështetur në dëshmitë e dëshmitarit Bislim Zyrapit. Zyrapit gjatë luftës ka qenë shef i Shtabit të UÇK-së. “Zyrapit ka dëshmuar disa herë për këto dokumente në Hagë. Ai ka dëshmuar se këto rregulla ishin thjesht në nivel aspirate, nuk u vunë asnjëherë në jetë, ishin projekt-dokumente që nuk kishin të bënin asgjë me realitetin”, ka thënë Emmersoni. Ai ka thënë se këto dokumente, që u hartuan në fund të vitit 1998, kishin për synim që ta bënin më profesionale UÇK-në “...për ta konvertuar nga një forcë guerile, në një ushtri që do të ishte e aftë për ta mbrojtur popullatën civile nga një fushatë e spastrimit etnik”, ka thënë ai.

Ben Emmersoni ka thënë se disa persona kanë ekzagjeruar rolin e tyre në UÇK për qëllime politike e disa të tjerë janë distancuar për shkak të frikës se mund të përballen me një gjykim. “Disa persona e kanë ekzagjeruar rolin e tyre në UÇK shpesh për qëllime të aktualitetit politik të ditës, por të tjerë janë përpjekur të distancohen nga ngjarjet, sepse e kanë ditur se disa prej veprimeve të tyre kanë qenë të dyshimta dhe mund të dilnin një ditë para një gjykate penale”, ka thënë ai.

Sipas Emmersonit, gjatë këtij gjykimi do të paraqitet një panoramë e ndërlikuar e një periudhe kaotike për shkak të distancës kohore prej kur ka ndodhur lufta e deri të nisja e gjyqimit. “Ngjarjet të cilat ju do t’i shihni kanë ndodhur thujse para 25 vjetësh dhe me keqbesim apo jo kujtimet edhe mund të dobësohen apo shtrembërohen”, ka thënë ai.

Emmersoni ka thënë se situata ndërlikohet edhe më shumë për shkak të propagandës së luftës, që tha se është përdorur nga të gjitha palët, përfshirë UÇK-në. Emmersoni ka thënë se klienti i tij dhe as UÇK-ja nuk i kanë shënjestruar mbështetësit e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). “Një prej të metave në thelbin e provave që ka prokuroria



është nocioni që e mendon një numër relativisht i vogël i individëve, që udhëheqja e UÇK-së ka komplotuar së bashku për të vënë në shënjestër mbështetësit e LDK-së për t’i përndjekur por, siç do ta dëgjoni, ky është një mendim krejt i ndryshëm nga ajo që ka ndodhur në terren”, ka thënë ai. Sipas Emmersonit, “shumica e anëtarëve të UÇK-së ishin mbështetës të LDK-së”. “Nuk ishin dy grupe më vete, ishin të ndërthurura. Konflikte ka pasur, dallime në mendime ka pasur, si në çdo rast kur bashkohen dy forca politike”, ka thënë Emmersoni.

Selimi: S’kam frikë nga drejtësia, por nga padrejtësia duhet të kemi frikë të gjithë

Të martën në Gjykatën Speciale ka folur edhe një nga liderët e UÇK-së, Rexhep Selimi. Ai para trupit gjykues ka thënë se nuk ka të bëjë me asnjë nga krimet e

pretenduar në aktakuzën ndaj tij. “Jemi këtu përballë një aktakuze që ende vazhdojmë ta konsiderojmë të pabazuar mbi fakte dhe argumente”, ka thënë Selimi. Ai ka thënë se shpreson që në fund të procesit do të vërtetohet pafajësia e tij. “Pas themelimit të kësaj gjykate, jo rrallëherë jam pyetur se a kisha frikë nga drejtësia. Gjithmonë kam thënë dhe sot e përsëris: unë nuk kam frikë nga drejtësia, por nga padrejtësia duhet të kemi frikë të gjithë. Por, pavarësisht kësaj, unë qëndroj sot përballë jush me besimin e plotë se në fund të këtij procesi ju do të vendosni në favor të pafajësisë time”, ka thënë Selimi. Ai ka thënë se Kosova nuk kishte një ushtri të mirëfilltë, të organizuar mirë, kishte mungesë të armëve e njerëzve. Kosova, sipas tij, nuk do ta zgjidhte kurrë luftën, por lufta, sipas tij, “ishte domosdoshmëri për mbijetesë”.

Ndërsa avokati mbrojtës i Selimit, Geoffrey Roberts, duke iu referuar fjalimit të klientit të tij, ka thënë se

është “e kuptueshme pse Selimi dhe të tjerët e ndiejnë njëfarë detyrimi për ta mbrojtur trashëgiminë e UÇK-së, kur kjo e fundit ishte qartazi në sulmin e kësaj prokurorie”. “Dëgjuam dje ZPS-në të thotë se kjo çështje nuk përbën procesim penal ndaj UÇK-së. Megjithatë, përtej fjalëve të zgjedhura me kujdes, të rëndësishme janë veprimet e ZPS-së”, ka thënë Roberts, duke shtuar se prokuroria ka dështuar ta përmendë krizën ekzistenciale në të cilën gjendeshin shqiptarët e Kosovës që vendosën ta nisnin luftë për liri.

Ai, po ashtu, ka thënë se gjatë deklaratës hyrëse të ZPS-së, ky institucion iu referua masakrave në Kosovë, sikurse ajo në Prekaz të Skenderajt “si ngjarje” dhe, sipas tij, ky mohim i krimet të serbëve ndaj shqiptarëve “nuk është asgjë tjetër veçse manipulim i ZPS-së”.

Pas fjalëve hyrëse të avokatëve të Thaçit, Veselit dhe Selimit, sot (e mërkurë) radhën do ta ketë mbrojtja e Jakup Krasniqit.



Qytetarët do ta përzgjedhin mjekun familjar brenda zonës së banimit

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 PRILL - Ministria e Shëndetësisë ka miratuar kohë më parë planin e veprimtimit për përcaktimin e kriterëve për regjistrin e banorëve në Kujdesin Parësor Shëndetësor. Qëllimi i këtij plani është që secili qytetar ta ketë mundësinë ta përzgjedhë mjekun familjar brenda zonës së banimit dhe sigurimit të qasjes në shërbime shëndetësore në kohën e duhur dhe sipas kërkesës.

Ministria e Shëndetësisë ka theksuar se përmes përzgjedhjes së mjekut familjar do të krijohet lista e banorëve/pacientëve dhe kjo do të kontribuojë në rritjen e mbulueshmërisë së popullatës me shërbime shëndetësore. “Rrjedhimisht, kjo do të ndikojë edhe në promovimin, edukimin dhe parandalimin e sëmundjeve të ndryshme, ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për shërbimet që ofrohen në Kujdesin Parësor Shëndetësor. Plani e thekson rëndësinë e

përzgjedhjes së mjekut familjar për ruajtjen dhe përcjelljen e shëndetit të qytetarëve në vazhdimësi dhe përfitimet e qytetarëve nga ky proces”, ka njoftuar MSh-ja. Fillimisht, procesi do të pilotohet në katër komuna: Lipjan, Istog, Prizren dhe Prishtinë (QMF-5- Ulpianë dhe QMF-6- Bregu i Dellit), për të vazhduar pastaj shtrirjen në tërë vendin. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se do t’i mbajë të informuar qytetarët për hapat e mëtejme në procesin e



përzgjedhjes së mjekut banimit dhe ecurinë e familjar brenda zonës së mëtejme.

Paraqitet raportit njëvjeçar i zbatimit të Strategjisë së Sundimit të Ligjit



PRISHTINË, 4 PRILL - Ministria e Drejtësisë ka organizuar takimin e radhës të Komitetit Drejtues të Strategjisë për Sundimin e Ligjit për të diskutuar rreth raportit njëvjeçar për zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit, Rregullat e Procedurës të strukturave institucionale të

Strategjisë, si dhe Analizat e Politikave që u paraprijnë planit të ri të veprimtimit 2024-2026. Para anëtarëve të këtij Komiteti ministrja Haxhiu ka shpalosur punën dhe aktivitetet e Ministrisë së Drejtësisë të cilat janë ndërmarrë me synim të reformimit të sistemit të drejtësisë

në vend. Marrë parasysh rezultatet e raportit njëvjeçar për zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit, ministrja Haxhiu u shpreh e bindur se kjo strategji është një nga instrumentet kryesore që ndihmon këtë reformë dhe, rrjedhimisht, arrijten e rezultateve

të rëndësishme. Ministrja Haxhiu falënderoi për bashkëpunimin e ofruar të gjitha institucionet e përfshira të cilat me nënshkrimin e këtij dokumenti janë zotuar për zbatimin e aktivitetëve tejet të rëndësishme për reformimin e sistemit të drejtësisë.

Haxhiu bëri me dije se Ministria e Drejtësisë ka miratuar një numër të madh të politikave, akteve ligjore e nënligjore të cilat janë të rëndësishme dhe shtrojnë rrugën drejt zbatimit të suksesshëm të reformës, ku njëherësh ka arritur të zbatojë në mënyrë të plotë 43 për qind të aktiviteteve përkatëse. “Përkundër këtij suksesi të arritur, këto ndryshime ligjore do të përcillen në të ardhmen edhe me masa zbatuese konkrete, ashtu që ligjet e politikat mos të mbesin vetëm në letër, por të arrijnë te qytetarët, pra që ata të përfitojnë nga një sistem i drejtësisë i reformuar - siç edhe e meritojnë”, ka thënë Haxhiu.

Ajo ka përmendur edhe progresin që është arritur në zhvillimin e agjencive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, përfshirë mobilizimin që është bërë me odat e profesionistëve të lira për t’i zbatuar detyrimet e tyre me qëllim që të sigurohet efikasitet dhe që puna e tyre ndërlihet drejtpërdrejt edhe me efikasitetin e gjyqësorit.

Në mbyllje të fjalës së saj, ministrja Haxhiu ka falënderuar edhe partnerët ndërkombëtarë dhe pjesëtarët e shoqërisë civile për bashkëpunimin korrekt dhe shumë të dobishëm, duke luajtur një rol kyç në këtë reformë dhe në arrijten e rezultateve të dëshiruara.

Plani i zbatimit të marrëveshjes, takohen Varheleyi dhe Bislimi

BRUKSEL, 4 PRILL - Komisionari për Zgjerim dhe Fqinjësi i Bashkimit Evropian, Oliver Varheleyi, ka takuar të martën shefin e ekipit negociator të Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi. Varheleyi ka bërë me dije se me Bislimin kanë diskutuar agjendën e reformave të BE-së dhe detyrat që kanë përpara. “Nisja e ditës me zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi duke diskutuar agjendën e reformave të BE-së

dhe detyrat që kemi përpara dhe se si Komisioni do të jetë në gjendje të ndihmojë në zbatimin e rezultateve kur dialogu Prishtinë - Beograd të jetë i suksesshëm”, ka shkruar ai në “Twitter”. Bashkimi Evropian tha të hënën se shpreson që ajo që ka ndodhur ditët e fundit në veri të Kosovës nuk do të ndikojë në takimin e kryenegociatorëve të Prishtinës dhe Beogradit. Bashkimi Evropian e ka quajtur marrëveshjen si kalim në një

fazë të re në dialog, nga faza e krizave në një fazë të normalizimit. Por, zhvillimet e fundit në veri e kanë kthyer frikën e përsëritjes së tensioneve. Mbrëmjen e së shtunës janë djegur tri vetura në Leposaviq, komunë e banuar me shumicë serbe në veri të Kosovës. Dy prej veturave ishin me targa RKS, ndërsa njëra me targa të Beogradit. Më pas, Policia e Kosovës njoftoi se e kishte arrestuar një pjesëtar të



komunitetit serb në Mitrovicën të tjera, ka marrë pjesë në e Veriut nën dyshimin se, ndër djegien e një veture.

780 mijë euro pajisje për IKShPK-në

PRISHTINË, 4 PRILL - Ministria e Shëndetësisë përmes fondeve të projektit "Kosovo Emergency Covid-19 Project-AF", financiar nga kredia e Bankës Botërore, ka nënshkruar kontrata me disa operatorë ekonomikë për furnizim me pajisje laboratorike, frigoriferë, kabinete të sigurisë, mikroskopë, material harxhuese, kite etj., ku përfitues i drejtpërdrejtë është Instituti

Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK).

Vlera e përgjithshme e kontratave e ndarë në lote/pjesë është: 780 000.00 euro.

Në kuadër të këtij financimi, IKShPK do të furnizohet me pajisje laboratorike (Inkubatorë, Sterilizues me ajër të nxehtë, Autoklavë, Spectrophotometër, Sistemi automatik i monitorimit mjedisor në kohë

reale për parametrat fizikë etj.); Frigoriferë të llojeve të ndryshme (frigoriferë +2°C to +15°C; frigoriferë -25°C; frigoriferë -80°C etj.); Kabinete të sigurisë për mikrobiologjinë; Mikroskopë; Sistem për identifikimin automatik të mikroorganizmave dhe testeve të ndjeshmërisë; Kite dhe materiale harxhuese.



Ministria e Shëndetësisë rifillon kontraktimet sociale

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 PRILL - Ministria e Shëndetësisë ka nënshkruar kontratat me tetë organizata

joqeveritare (OJQ) në fushën e shëndetit mendor dhe sëmundjeve ngjitëse HIV dhe TB si politika të aprovuara nga ana e ministrit të Shëndetësisë.

Ministri i Shëndetësisë, Arben

Vitia, ka pritur në takim OJQ-të përfituese të mbështetjes financiare nga MSH-ja dhe i ka uruar ato duke theksuar se personat që do të marrin shërbime nga projektet janë persona që

kanë më së shumti nevojë për shërbime të këtyre fushave. Ministria e Shëndetësisë i ka planifikuar kontraktimet sociale në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2023, 2024

dhe 2025.

Nënshkrimi të kontratave me tetë OJQ përfituese të kësaj mbështetje financiare i ka paraprirë procesi i planifikimit dhe shpalljes së thirrjes publike, e cila ka qenë transparente për të gjitha OJQ-të.

Vlera e mbështetjes financiare për organizatat përfituese nga kontraktimet sociale "Promovimi i shëndetit mendor dhe parandalimi i sëmundjeve infektive HIV dhe TB" është: 78.240 euro.

Në vitin 2019 ka qenë hera e fundit që MSH-ja ka zhvilluar kontraktime sociale dhe pas përmirësimit të situatës lidhur me pandeminë Covid-19 i është rikthyer këtij procesi duke ndarë rishtas buxhetin për këto dy komponentë për kontraktime sociale me qëllim të sigurimit dhe zbatimit të misionit të MSH-së, duke ofruar shërbime cilësore dhe të sigurta për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Kurti takoi emisarët e Gjermanisë dhe të Austrisë për Ballkanin Perëndimor, diskutohet për dialogun

PRISHTINË, 4 PRILL - Kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar nga ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, dhe ushtruesja e detyrës e shefes së grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ishte i ftuar të hënën në mbrëmje nga ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde në rezidencë, në një darkë pune së bashku me emisarin e Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin dhe përfaqësuesin special të Austrisë

për Ballkan Perëndimor, Johannes Eigner.

Gjatë darkës u diskutua për zhvillimet e fundit në Kosovë dhe rajon dhe për rëndësinë e bashkëpunimit rajonal. "Temë diskutimi ishin, po ashtu, raportet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, zbatimi i marrëveshjes bazë të arritur në Bruksel dhe aneksit të saj të dakorduar në Ohër si dhe rruga përpara, në prag të takimit të radhës në nivel kryenegociatorësh që do të zhvillohet sot në Bruksel", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.



Osmani përkujton 24-vjetorin e masakrës së Kralanit

PRISHTINË, 4 PRILL - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka përkujtuar 24-vjetorin e masakrës së Kralanit. "Sot kujtojmë 86 civilët e rrëmbyer nga forcat

gjenocidale të Serbisë në Kralan të Gjakovës, të cilët u ndanë nga kolona e të zhvendosurve, të mbledhur në këtë fshat. Civilë moshash të ndryshme, pleq, gra, burra e

fëmijë, u vranë mizorisht nga regjimi kriminal serb ose u zhdukën dhunshëm. Sot e kësaj dite, nënat, motrat e familjarët e tjerë presin në ankth ndonjë lajm për fatin e

më të dashurve të tyre, të zhdukur me dhunë nga regjimi serb. Drejtësi për viktimat dhe kujtim i përhershëm për to!", ka deklaruar Osmani.



Ekzekutohet paga për 500 punëtorët e parë të "Superpunës"

PRISHTINË, 4 PRILL - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka bërë me dije të martën se 500 të punësuarit e parë tashmë kanë marrë pagën e parë dhe superpuna ka ekzekutuar subvencionin për muajin shkurt. Ai ka sqaruar edhe procedurat që duhet t'i kryejnë bizneset për t'i verifikuar punëtorët.

"Bizneset që angazhojnë punëtorë përmes superpuna duhet të kalojnë verifikimet si në vijim: Të deklarojnë punëtorët e angazhuar në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK); Të deklarojnë punëtorët në ATK me pagë të njëjtë apo më të lartë sesa në shpalljen në superpuna; Të mos kenë obligime tatimore të papaguara ndaj ATK-së", ka

njoftuar Murati në "Facebook". Përmes platformës online "superpuna", të gjithë punëkërkuarit të cilët nuk kanë pasur kontratë pune paraprake dhe këtë e bëjnë për herë të parë, përmes platformës, qeveria do të subvencionojë 264 euro rrogë për 6 muajt e parë të punës, në kompaninë që e gjejnë po përmes kësaj platforme.



Gërxhaliu thotë se ishin pesë faktorë që ndikuan në rritjen e të hyrave të brendshme të ATK-së



PRISHTINË, 4 PRILL - Ish-kryetari i Odës Ekonomike, Safet Gërxhaliu, ka theksuar se raporti i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) vlerëson lart performancën e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Sipas tij, ky raport pasqyron saktë rritjen e të hyrave tatimore, si rritjen më të madhe të Kosovës në Ballkanin Perëndimor. "Ndërsa sipas këtij raporti

konfirmohet se 1/3 e rritjes i atribuohet rritjes së formalizimit të ekonomisë si rezultat i inspektimeve dhe kontrolleve të ATK-së. Një pjesë e të hyrave sipas këtij raporti është rritur edhe si rezultat i rritjes ekonomike dhe rritjes së formalizimit të punëtorëve (TAP)", ka shkruar Gërxhaliu në "Facebook". Ai ka theksuar se totali i të hyrave në vitin 2022 ka qenë

2.25 miliardë euro. "Të hyrat e ATK-së në vitin 2022 = 723.9 milionë euro. Të hyrat e Doganës në vitin 2022= 1.52 miliardë euro. Rritja e të hyrave në ATK vitin 2022 në raport me vitin paraprak ishte 21.4 për qind, ndërsa e Doganës 11.4 për qind", është shprehur Gërxhaliu. Ai ka thënë se rritja e të hyrave të brendshme nga ATK-ja ka ndodhur si rezultat i pesë

faktorëve. "1. Zgjerimi i bazës tatimore, me rritje të numrit të bizneseve paguese të tatimit (rreth 10 për qind rritje e numrit të bizneseve paguese). 2. Rritja e efikasitetit në inkasimin e borxheve tatimore. 3. Rritja e formalizimit të ekonomisë në përgjithësi, formalizimi i punëtorëve. 4. Qasja e re e trajtimit të rreziqeve mospërmbushjes tatimore,

pra nga viti 2019 kemi qasje sektoriale të trajtimit rreziqeve tatimore. 5. Ngritja e llogaridhënies dhe përgjegjësisë tek stafi i ATK-së, pra kemi ngritje të disiplinës në ATK. Kjo dëshmon se partneriteti publiko-privat në Kosovë nuk ka alternativë dhe se sektori privat meriton trajtim më të mirë institucional", ka thënë Safet Gërxhaliu, njohës i ekonomisë.

KEDS-i: Erërat dhe reshjet e borës shkaktojnë dëme në rrjetin elektrik, disa zona mbesin pa rrymë

PRISHTINË, 4 PRILL - Kompania Kosovare për Distribucion të Energjisë Elektrike (KEDS) ka njoftuar se për shkak të erërave të forta dhe reshjeve të borës ka bërë që të shkaktohen dëme në rrjetin elektrik. Sipas KEDS-it, disa zona kanë mbetur pa rrymë, porse ekipet janë në

terren për ta kthyer në normalitet furnizimin e rregullt me energji elektrike. "Si pasojë e erërave dhe reshjeve të borës që përfshinë gjatë natës tërë Kosovën, janë shkakuar dëme në rrjetin elektrik. Disa dalje elektrike tashmë janë jashtë funksionit dhe, pavarësisht prej

kushteve të vështirësuar për punë në terren shkak i erës dhe borës që po vazhdon të bie edhe sot, ekipet e KEDS-it ndodhen në terren dhe janë të përkushtuara që ta kthejnë në normalitet furnizimin e rregullt me energji elektrike", thuhet në njoftimin për medie.



AJAZ EMINI - Ditar (VIII)

NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT

ANGAZHIMET TONA TË REJA PAS ARDHJES NË KOSOVËN E LIRË

Pas ardhjes tonë në Kosovë, Njësia e Forcave Speciale të Armatës Amerikane me të cilën punova që nga Maji 1999, në koordinimin e caqeve të bombardimeve të aviacionit të NATO-së mbi trupat e forcave serbe nga Kukësi i Shqipërisë, tani morrëm detyrën e re.

Tani detyra jonë kryesore me Njësinë e Forcave Speciale në Kosovë, në fillim ishte për të përmbledhë sa më shumë informata në lidhje për çfarëdo ankese apo nevojë të popullatës lokale që kishin në Kosovë, mbrenda teritorit të sektorit të lindjes të KFOR-it amerikan, që përfshinë qytetet me rrethinë: Ferizaj, Gjiilan, Kamenicë, Viti, Kaçanik, Hanit të Elezit dhe Shtërpcës të caktuar nga aleanca e NATO's.

Filluam me vizitat e ndryshme nëpër vendbanime mbrenda teritorit të Lindjes apo siç e quanin sektorit amerikan, ku po takonim liderët e komuniteteve të ndryshme të fshatrave dhe qyteteve të këtij sektori, prej nga po informoheshim për ankesat dhe kërkesat e llojlojshme të popullatës lokale. Gjatë këtyre takimeve mblidhëm informata për vendet e minuara, varret masive, kërkesat e shërbimeve mjekësore, informata për krimet dhe kriminelët e luftës. Pastaj me ato informata iu drejttoheshim departamenteve të ndryshme përkatëse civile apo ushtarake të atyre lëmive për çfarë ishin ankesat apo kërkesat, për t'u shqyrtuar apo edhe ndihmuar në ato probleme që kishin.

E premte, 18 qershor 1999

Pas ardhjes tonë në Kosovë koha këtyre ditëve po mbante ftohtë dhe me reshje shiu, e që më tepër i përngjante ditëve të vjeshtës. Natën e parë në Kosovën e lirë e kaluam në një shtëpi të re të pa kryer nga punimet, e që ishte ende pa dyer dhe pa dritare. Pasi se u zgjuam herët në mëngjes, aty në afërsi nën mbulesën e deryve të oborrit të kësaj shtëpie gjetëm një tank të ushtrisë jugosllave që kishte mbetë e shkatërruar nga bombardimet e aviacionit të NATO-së. Aty për rreth ku ishim pamë edhe shumë shtëpi të djegura dhe të shkatërruara nga forcat paramilitare ushtarake serbe. Ky vend dukej sikur të ishte edhe si pikë strategjike që ishte shfrytëzuar nga forcat serbe, që po dukej nga mbeturinat ushqimore që kishin lënë pas veti. Ishte pikë strategjike se kishte përballë rrugën Gjilan-Ferizaj prej ku mundë të vëzhgohej në një horizont mjaftë të gjërë. Përballë kësaj shtëpie ku ne qëndruam, në bregoren përballë, në anën e kundërt të rrugës Ferizaj-Gjiilan ku më vonë do të vendoset Kampi



Ushtarak Amerikan "Bondsteel". Aty ku më vonë do të vendoseshim edhe ne me forcat paqëruajtëse të armatës amerikane e që do të ishin nën ombrellën e KFOR-it, sipas Marrëveshjes Teknike Ushtarake të Kumanovës!

Informacionet e 24 orëve të fundit

Sipas informatave të NATO-së, më shumë se 30,000 pjesëtarë të ushtrisë jugosllave prej 40,000 sa kishin qenë në Kosovë, veçse ishin tërhequr jashta kufinjve kosovarë.

NATO-ja parashef se deri më 20 Qershor 1999, kur ishte caktuar dita e fundit e tërheqjes së trupave jugosllave, do të përmbushet në tërësi sipas marrëveshjes së nënshkruar.

Gjatë mëngjesit të sotëm, NATO-ja raportoi se gjerë më tani në Kosovë kishin hyrë rreth 16,100 trupa paqëruajtëse, edhe 10,846 ende ishin në Maqedoni.

Sot në Maqedoni në afërsi të bazës së KFOR-it kishte patur një eksplozim, por fatmirësisht nuk kishte viktima.

Në Prizren, në sektorin gjerman pjesëtarët e UÇK's ishin pajtuar që nga mesnata e sotme të mos bartnin armë dhe uniforma ushtarake. Ndërsa në pjesët tjera të Kosovës ende po shifeshin pjesëtarët e UÇK's duke u endë rrugëve me armët dhe uniformat e tyre.

Gjatë ditës së djeshme ishte paraqitë edhe udhëheqësi i UÇK-së Hashim Thaçi, i cili e porositi popullatën serbe që mos të largohen nga Kosova. Ai kishte thënë se: "Shoqërisë shqiptare i duhen edhe serbët, ata mundë të kontribuojnë në stabilitetin e Kosovës".

Sipas zyrtarëve të UNHCR-së sot, ata thanë se kthimi i refugjatëve kosovarë në mënyrë të organizuar mundë të fillonjë kthimin e tyre mbrenda dy javësh, por pa marrë parasysh shumica e tyre veçse kishin filluar të kthehen në shtëpitë e tyre.

Sipas informatave të tyre, 13,500 refugjatë shqiptarë etnik veçse e kishin lëshuar Maqedoninë për në shtëpitë e tyre në Kosovë, si dhe 37,000 refugjatët e tjerë e kishin lëshuar edhe Shqipërinë. Autoritetet malazeze kishin raportuar se mbrenda shtetit të tyre tani ditëve të fundit kishin hyrë rreth 18,800 refugjatë nga Kosova. Sipas NATO-së mendohet se deri më tani 33,000 serbë prej popullatës së përgjithshme të 150,000 serbëve, e kishin lëshuar Kosovën. Shumica prej tyre po largoheshin nga frika e hakmarrjes nga shqiptarët që kishin humbur pjesëtarët e familjeve të tyre, apo edhe mundë të kenë qenë të involvuar në krimet kundër fqinjëve të tyre të popullatës shqiptare.

Gjatë ditës së djeshme edhe Senati Amerikan e aprovoi ndihmën prej \$150 Milion ndihmë për rimëkëmbjen e Kosovës, kurëse në të njëjtën kohë e shpalli Serbinë si shtet terrorist...

E shtunë, 19 qershor 1999

Njësisë tonë tani sa n'a u caktua që të shkojmë në qytetin e Gjiilanit, për të mbikqyrë gjendjen në qytet dhe rrethinë. Pas marrjes së vendimit menjëherë u nisëm në drejtim të Gjiilanit. Gjatë rrugës Ferizaj-Gjiilan, duke kaluar përmes fshatrave të ndryshme në veçanti të atyre me popullatë shqiptare, takonim turma njerëzish të të gjitha moshave të cilët kishin dalë për rrethë rrugës kryesore, e të cilët posa n'a shihnin nga distanca me automjetet ushtarake, fillonin që të n'a përshëndesnin me duartrokitje dhe duke bërë: "NATO, NATO, NATO" e shpeshherë edhe n'a gjuanin ndonjë tufë lulesh të freskëta! Pritja ishte më madhështorja që kishim parë dhe përjetuar ndonjëherë, edhe meqenëse unë isha mjaftë i prekshëm nga këto pamje që po përjetonim.

Shpeshherë më mbusheshin sytë me lotë kur i shihnja se me çfarë gëzimi po na prisnin, sepse edhe unë vetë i kisha parë dhe përjetuar dhimbjet e tyre të gjerëtanishme. Edhe unë kisha pjesëtarë të familjes në Kosovë dhe Maqedoni që n'a u kishin denuar dhe persekutuar nga regjimi fashist sllav të jugosllavisë. Po edhe kolegë të mijë amerikan me të cilët ishim së bashku nga Maji 1999, atëherë kur po bënim dirijimin e bombardimeve të aviacionit të NATO-së me ndihmën e vëzhguesve të UÇK-së dhe ndërmjetësit tonë Gjeneralit Kudusi Lama nga Kukësi i Shqipërisë, mbetën të mahnitur për këtë mikpritje. Po, sepse ata gjatë tërë karrierës së tyre si profesionistë ushtarak nuk u kishte ndodhur diçka e tillë.

Njësisë së Forcave Speciale të Armatës Amerikane me të cilët bashkëpunova unë, i sqarova arsyen se pse iu duan kaq shumë shqiptarët, dhe duke i këshilluar se nëse do të kemi sjellje korrekte me këtë popullatë të përvuajtur dhe maltretuar nga kriminelët serbë, nga këta njerëz do të kemi rrespektin më të madhë të jetës tonë! I tregova edhe për doket, traditat dhe bujarinë e popullit shqiptarë, i tregova se e kemi traditë që miqtë tanë t'i respektojmë dhe më tepër se veten, e në veçanti amerikanët të cilët u bënë inicuesit kryesorë që të ndërhyjë NATO-ja në çlirimin e Kosovës! Gjithëkund nga po shkonim pritjet tona na bëheshin me të vërtetë madhështore! N'a pritën saktë si çlirimtarë me duartrokitje gjithëandë ashtu siç priten forcat çlirimtare të vendit! Me të arritur në Gjiilan shkuam edhe ne dhe u vendosëm në Shkollën Fillore "Abaz Ajeti", e cila ishte një godinë dy katëshe e që ndodhej në pjesën dalëse të qytetit në rrugën për në Preshevë. Në atë shkollë gjetëm të vendosur pjesëtarët e Marinës Amerikane të cilët ishin vendosë në këtë objekt që nga 11 qershori 1999. Nga paqëruajtësit amerikan ishte

Marina Amerikane e para që hyri në Kosovë, forcë e cila për shkak të lëvizjes së tyre më të lehtë. Ajo është edhe më tepër e përbërë nga forca të këmbësorisë, edhe armatim më të lehtë, ku ata edhe janë gati çdoherë forca e parë ushtarake që futen pas fitores së akcioneve luftarake. Marinsat Amerikan janë edhe si forcë pastruese para se të futen pjesa tjetër e Armatës Amerikane me armatim më të rëndë.

Gjatë kohës së qëndrimit tonë në këtë shkollë, nga radhët e Marinsave Amerikan njoftova edhe një të rijë shqiptarë që ishte i lindur në Teksas (Texas) të Amerikës, i cili kishte ardhë me njësinë e tij dhe po shërbente si pjesëtarë i sajë në Kosovë. Ky ushtarë i rijë shqiptaro amerikan i kishte prindët e ardhur në Amerikë nga Dibra e Maqedonisë. Gjatë bisedës me të, më tregoi se përderisa po patrollonin në fshatin Shillovë të Gjiilanit, fshat me popullatë serbe, e aty ku edhe ishin përqendruar edhe shumë paramilitarë kriminel serbë nga lufta e Kosovës, pasi se ia shohin mbiemrin shqiptar këtij marinsi amerikan, menjëherë ata përhapin fjalët se amerikanët tani në aradhat e tyre ushtarake në Kosovë kanë marrë edhe i kanë aktivizuar si pjesë të trye edhe pjesëtarët e UÇK-s, të cilëve tani ua paskan ndërruar vetëmse uniformat ushtarake!

Pas disa ditësh derisa ne po vizitonim fshatin Gorni Kuc të Gjiilanit, fshat me popullatë serbe, gjate bisedës me popullatën lokale një serb i moshës së mesme m'u drejtua mua dhe më tha: "Ju të gjithë po thoni se keni ardhë nga Amerika si përkthyes, por në realitet deri para disa ditësh juve keni qenë pjesëtarë të UÇK's, e tani amerikanët iu kanë marrë kinse përkthyes, por qëllimi kryesorë i tyre është për të na arrestuar neve serbëve më lehtë. Ju nuk jeni amerikan, sepse amerikanët nuk flasin serbisht dhe shqip!"

Në shkollën ku ne u vendosëm, neve na dhanë një klasë të zbrazët në fund të koridorit të katit të dytë, pa kurrëfarë përzierje me njësinë e marinsave që ishin vendosur aty, për shkak se ne ishim degë e posaçme ushtarake, dhe kishim mision krejtë ndryshe nga ato! Pasi nxorrëm plaçkat tona nga makinat që kishim dhe i sollëm në klasën e veçantë, pak më vonë dolëm në qytet për të parë gjendjen e pasluftës, por edhe me qëllim që të blejmë disa gjëra ushqimore. Qyteti ende ishte i boshaditur dhe tejet i zbrazët, nuk kishte aq shumë njerëz rrugëve të qytetit! Shitoret posa kishin filluar të hapen, edhe ishin në një numër shumë të vogël, ishin hapur veçse disa prej tyre! Shumica e shitoreve nëpër qytet kishin dritaret e thyera dhe dukeshin se ishin të plaçkitura tërësisht, edhe ato shitore që kishin filluar punën e tyre, gjithëandë shihesh mungesa e ç'do

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Derbi në Mitrovicë

PRISHTINË, 4 PRILL - Sonte (e mërkurë) prej orës 20:30 zhvillohet derbi i xhiros së 25-të në Superligën A të Kosovës në hendboll. Takohen Trepça e Rahoveci. Trepça është e dyta me 30 pikë, ndërsa Rahoveci është i treti me 23 pikë. Rahoveci është pjesë e garës së fortë

për plejof. Nga 23 pikë në pozitën katër e pesë i kanë Prishtina dhe Vushtrria. Kastrioti është i gjashti me 19 pikë. Rahoveci fitoi ndaj Prishtinës në xhiron e kaluar dhe do të përpiqet ta fitojë edhe një ndeshje të rëndësishme. Nga udhëtimi i kaluar në Mitrovicë,

“vreshtarët” janë kthyer me pikë të plota. Por Trepça është në seri fitoresh dhe këtë herë synon t’i mbajë pikët për vete. Dy ndeshjet e tjera janë të enjten. Kastrioti e ka thuar rastin e fundit për të hyrë në garë për plejof. Takohet me Vushtrrinë nga ora 18:00, në palestrën në

Shtime. Kampionia dhe liderja e klasifikimit, Besa Famgas, luan në kryeqytet ndaj Prishtinës, të enjten prej orës 20:30. Prishtina është në krizë të rezultateve dhe do të mundohet të reagojë. Ndërkohë Besa pasi ka humbur pikë të dielën në Prishtinë, do të mundohet të



kthehet te fitorja. Besa udhëheq me 42 pikë dhe ka siguruar vendin e parë për plejof.

FFK-ja reagon lidhur me aktivitetet ilegale të klubeve serbe në Kosovë

PRISHTINË, 4 PRILL - Federata e Futbollit e Kosovës dënon ashpër zhvillimin e garave ilegale të futbollit nga ana e strukturave të Serbisë brenda territorit të Kosovës. FFK është anëtare me të drejta të plota në UEFA që nga maji i vitit 2016 dhe është institucioni i vetëm me statutin e UEFA-s dhe të FFK-së që bën organizimin e garave të futbollit në Republikën e Kosovës. “Raportimet e fundit në media për zhvillimin e ndeshjeve garuese nga struktura ilegale të Serbisë brenda territorit të Kosovës, ndonëse në nivele amatore, janë shqetësuese dhe të papranueshme. FFK-ja edhe më herët i ka diskutuar këto dukuri brenda Këshillit për Sport dhe ka

kërkuar ndërmarjet e masave të menjëshme. Aktivitetet e tilla e cenojnë autoritetin e FFK-së dhe sovranitetin e Kosovës në përgjithësi. FFK kërkon nga të gjithë faktorët relevantë të shtetit, Këshilli për Sport dhe organet e rendit, që të ndërmarrin hetime urgjente dhe t’i ndalojnë aktivitetet e tilla ilegale dhe është e gatshme të ndihmojë me ekspertizë dhe mbështetje përmes mekanizmave të UEFA-s dhe FIFA-s”, thuhet në reagimin e FFK-së.

Federata e Futbollit e Kosovës është shprehur e hapur për bashkëpunim dhe mbështetje për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetin



serb, por ka bërë me dije se nuk mund të lejojë zhvillimin e aktiviteteve të strukturave ilegale, që në kundërshtim me rregullat e UEFA-s bëjnë organizim të ndeshjeve të futbollit brenda territorit të Kosovës. FFK-ja është e vendosur të bëjë çdo gjë që është në kompetencat e saj për t’i ndaluar këto aktivitete. FFK-ja, gjithashtu, është shprehur e

shqetësuar me pengesat që i ka nga MKRS-ja lidhur me licencim. Madje FFK-ja pretendon se ky veprim kundrejt pavarësisë së FFK-së i kanë trimëruar strukturat ilegale të Serbisë. “Njëherësh shprehim shqetësimin tonë në lidhje me pengesat që i ka krijuar MKRS në lidhje me moslicencimin e FFK-së përkundër plotësimit të dokumentacionit si dhe

ndërhyrjet e vazhdueshme të fundit të organeve të hetuesisë në pavarësinë e FFK-së. Si duket pikërisht këto veprime të autoriteteve të Kosovës kundrejt pavarësisë së FFK-së i kanë trimëruar strukturat ilegale të Serbisë që të organizojnë aktivitete të futbollit në Kosovë. Lidhur me këto aktivitete ilegale e ndërhyrje direkte të Serbisë, si dhe procesin e licencimit dhe zhvillimet e fundit nga organet e hetuesisë kundrejt FFK-së, do të reagojmë dhe do të kërkojmë intervenimin e UEFA-s gjatë takimeve që do t’i ketë delegacioni i Kosovës në Kongresin e radhës të UEFA-s që do të mbahet nesër në Lisbonë të Portugalisë”, thuhet në reagimin e FFK-së.

Kosova zyrtarisht shtet kandidat për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030

PRISHTINË, 4 PRILL - Lojërat Olimpikë Mesdhetare në vitin 2023 mund të organizohen në Kosovë. Në fakt, Kosova është edhe zyrtarisht në mesin e shteteve kandidate për organizimin e Lojërave Mesdhetare që do të mbahen në vitin 2030. Lajmin e ka thënë kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, pas një takimi që pati me presidentin e Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi. Kurti ka thënë se kjo kandidaturë do të shënojë një moment historik të zhvillimit të sportit në Kosovë. Ai bëri me dije se është arritur marrëveshja me Shqipërinë që



ky eveniment sportiv të zhvillohet në bregdetin shqiptar. “Jemi pajtuar me Shqipërinë se këto lojëra do të zhvillohen më bregdetin shqiptar. Mbështetjen për sportin e kemi rritur 200 për qind”, ka thënë Kurti.

Për kandidaturën e Komitetit Olimpik të Kosovës ka njoftuar edhe Komiteti Ndërkombëtar i Lojërave Mesdhetare. Në njoftim thuhet se afati i fundit për aplikim për organizimin e lojërave për vitin 2027 dhe 2030 ka përfunduar më 31 mars. Për organizimin e lojërave në plazh për 2027-n ka konkurruar Portugalia, ndërkaj tri vjet më pas Kosova. Sipas ICMG-së, dy Komitetet Olimpikë Kombëtare duhet ta dorëzojnë dosjen e kandidaturës deri në fund të qershorit, ndërsa Komisioni Vlerësues do të organizojë ndërkohë vizita inspektuese në të dy vende, në Portugali dhe në

Kosovë. Më pas, më 8 shtator, në Heraklion, gjatë asamblesë gjenerale të ISMG-së, do të vendoset për Lojërat e 21-ta Mesdhetare dhe për Lojërat e katërta Mesdhetare në Plazh. “Komiteti Ndërkombëtar i Lojërave Mesdhetare e mirëpret me kënaqësi të madhe interesimin e dy Komiteteve Olimpikë të cilët janë anëtarët më të rinj të familjes Mesdhetare. Përkushtimi i tyre kontribuon në zhvillimin e kësaj ngjarjeje, por edhe në përhapjen e idealeve dhe të vlerave të Lojërave në krejt pellgun e Mesdheut”, shkruan ICMG në uebfaqen e vetë

zyrtare, e cila shton se kandidaturat e Kosovës dhe të Portugalisë do të shqyrtohen me kujdes nga ekspertët dhe më pas do të vendoset nëse i plotësojnë kriteret apo jo, njofton Komiteti Ndërkombëtar i Lojërave Mesdhetare. Kryeqyteti i Kosovës, Prishtina, mund të jetë mikpritëse e mijëra sportistëve që do të marrin pjesë në këtë garë prestigjioze. Kosova është treguar mjaft e suksesshme në pjesëmarrjet e saj në Lojërat Mesdhetare, mbi të gjitha në sportin e xhudos, duke fituar medalje të arta, të argjendta dhe të bronzta.

Sot zhvillohen gjysmëfinalet e para të Kupës në futboll

PRISHTINË, 4 PRILL - Sot (e mërkurë) do të zhvillohen ndeshjet e para gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në futboll. Sfidat kryesore do të jetë ajo që

zhvillohet në stadiumin “Zahir Pajaziti” në Podujevë, ku ballafaqohen Llapi me Gjilanin. Menjëherë pas hedhjes së shortit, përfaqësuesit e të dy klubeve

kishin shprehur qëllimin e tyre për ta prekur finalen e këtij kompeticioni. Gjysmëfinalja tjetër është ajo ndërmjet Vushtrrisë dhe Prishtinës, me

klubin bardh e kaltër që shihet si skuadër favorite për të kaluar në finalen e madhe të Kupës së Kosovës. Ndeshjet kthyes do të zhvillohen më 19 prill.



Ancelotti, Barcelonës: Është koha ne të fitojmë në 'El Clasico'

MADRID, 4 PRILL - Real Madridi sonte (e mërkurë) do të përballet me Barcelonën në "Camp Nou" në kuadër të ndeshjes së dytë të gjysmëfinaleve të Kupës së Mbretit nga ora 21:00. Ndeshja e parë në "Santiago

Bernabeu" u mbyll 1-0 në favor të kalatanasve. Trajneri i Realit, Carlo Ancelotti, ka komentuar në lidhje me ndeshjen ndaj Barcelonës. "Barcelona i ka fituar tri ndeshjet e fundit ndaj nesh, por mendoj se tani është

koha jonë ta fitojmë 'El Clasico' e së mërkurës. Një 'El Clasico' është gjithmonë ndeshja më e rëndësishme. Është një rivalitet shumë i madh dhe kjo na lejon të luajmë një finale. Është kyç", ka thënë Ancelotti.

Trajneri më pas theksoi se do të tentojnë të shënojnë gol dhe ta rikthejnë rezultatin në favor të tyre. "Ideja nuk është të çmendemi për të shënuar gol. Mund ta bëjmë në 90 minuta. Duhet ta kontrollosh mirë, si në ndeshjen e parë,



por me më shumë sukses", ka shtuar Ancelotti.

Zhegrova: Unë mund ta ndryshoj lojën, tifozët janë të jashtëzakonshëm

LILLE, 4 PRILL - Futbollisti i Kosovës, Edon Zhegrova, ka lënë gjurmë në ndeshjen që Lille e fitoi ndaj Lorientit. Zhegrova hyri në lojë tetë minuta pa përfunduar ndeshja dhe doli të ishte vendimtar me dy gola të shënuara. "Edhe nëse hyn në lojë për pesë, dhjetë apo njëzetë minuta, duhet ta japësh më të mirën nga vetja çdoherë që trajneri ta jep rastin. Është, po ashtu, stil i lojës sime, sepse unë mund ta ndryshoj lojën. Këtë e bëra dhe jam mjaft i lumtur që ia sigurova tri pikë ekipit", ka deklaruar Zhegrova në një intervistë me "le11hdf.fr". "Të jem i singertë, nuk kam ëndërruar ta bëja këtë, por doja ta jepja 100-përqindëshin nga vetja. Synim imi ishte ta ndihmoja ekipin dhe të shënoja gol. Pasi e bëra këtë, isha edhe më i motivuar, kështu që e shënova edhe golin e dytë", ka shtuar Zhegrova.



Pas ndeshjes ylli i Kosovës shkoi afër tifozëve, duke kënduar së bashku me ata. E ai u shpreh krenar që ata thirrën emrin e tij. "Ata janë të jashtëzakonshëm. Ata

e kënduar emrin tim, kjo më bën mjaft krenar. Gjithashtu, ata më thirrën dhe unë shkova. Jam mjaft i lumtur me mbështetjen e tyre.

Ata më thanë faleminderit. Ishin mjaft të lumtur. Unë, gjithashtu, ia dhashë fanellën time një vogëlushi", ka pohuar Zhegrova.

Marijuana nuk është më e ndaluar në NBA, basketbollistët mund ta pinë

NJU-JORK, 4 PRILL - NBA dhe NBPA nënshkruajnë një marrëveshje të re kolektive 7-vjeçare. Ndër ato që u ranë dakord është heqja e marijuanës nga lista e substancave të ndaluara në ligë. Pra, lojtarët do të mund të pinë marijuanë lirisht dhe nuk do të penalizohen nëse zbulohet në gjakun e tyre nëse testohen. Gjatë pandemisë, përdorimi i marijuanës nga lojtarët e NBA-së u rrit shumë. Basketbollistët kanë bërë thirrje për lejimin e kësaj substance dhe tashmë po festojnë. Shumë yje të NBA-së si Sean Kemp dhe Al Harrington kanë deklaruar se kjo substancë ka veti shëruese. Përveç kësaj, u vendos që të kishte një turne në mes të sezonit, ndërsa u ra dakord që në mënyrë që një atlet të pretendonte një çmim individual, ai do të duhej të kishte mbi 65 ndeshje në një sezon të rregullt.



Boksieri Khan përjashtohet nga të gjitha sportet shkak i dopingut

Boksieri britanik Amir Khan është përjashtuar nga të gjitha sportet për shkak të dopingut. Khan doli pozitiv vitin e kaluar pasi kishte përdorur substancën e

ndaluar Ostarine. "Më 19 shkurt 2022 Anti-Dopingun në Mbretërinë e Bashkuar mblodhi një mostër të urinës në garë nga z. Khan pas luftës së tij kundër Kell Brook

në Manchester Arena. Zotëri Khan's Sample ktheu një gjetje analitike negative për ostarinë", thuhet në njoftimin e Agjencisë Anti-Doping në Mbretërinë e

Bashkuar. 36-vjeçari llogaritet si një nga boksierët më të mirë britanikë në vitet e fundit, ndërsa ishte fitues i medaljes olimpike të argjendtë në

peshën e lehtë në Lojërat e Athinës 2004 kur ai ishte 17 vjeç për të fituar më pas rripin e WBA-së në vitin 2009 dhe shtoi titullin IBF më 2011.

SHKURT

Henry: Messi duhet të kthehet në Barcelonë

Thierry Henry, ish-shoku i skuadrës së Lionel Messit, mbrojti yllin argjentinas, i cili u kritikua nga tifozët e Paris Saint-Germainit: "Është e turpshme të dëgjosh vërshtëllimat në 'Parc de Princes'. Ai është një nga lojtarët më të mirë në ekip. Ai shënoi 13 gola dhe dhuroi 13 asistime". Ish-futbollisti francez, duke folur për Prime Video France, shprehu dëshirën e tij për ta parë sërish Messin në Barcelonë: "Nuk është lajm, është një dëshirë: Messi duhet të kthehet në Barcelonë".

Openda, Hazardit: Eja në Lens

Eden Hazard nuk po ka hapësirë në Real Madrid dhe largimi nga ky klub në afatin kalimtar të verës pritet të ndodhë. Sulmuesi i Lens, Lois Openda, ka kërkuar nga Hazard t'i zgjedhë ata nëse largohet nga Reali. "Edeni është një lojtar që më pëlqen dhe që më ka mahitur në kombëtaren belge. Nuk më intereson e kaluara e tij në Lille. Ai do të ishte një nënshkrim i shkëlqyer për ne", ka thënë Openda.

Nadali nuk merr pjesë në Mastersin e Montecarlos

Rafa Nadal nuk do të luajë në Mastersin e Montecarlos me spanjollin që lajmërimin e dha vetë në "Twitter". Rafa është ende duke u marrë me rikuperimin nga dëmtimet e shumta që e kanë prekur, pothuajse në të njëjtën kohë mes fundit të 2022-s dhe fillimit të 2023-s. Sidomos i fundit, një tërheqje në muskujt e sipërm të këmbës së majtë, që e kishte ndaluar në Australian Open kur mbronte titullin. "Nuk ndihem ende gati", shkruan Nadal. "Më duhet të humbas një prej turneve më të rëndësishëm të karrierës". Në Principatë Nadal, 14 herë kampion i Roland Garros, ka ngritur trofeun plot 11 herë, por nuk e fiton më që nga 2018. "Do të vazhdoj të përgatitem. Preferoj ta jetoj jetën ditë pas dite dhe do të kthehem kur gjërat të jenë tamam ashtu siç duhet. Nuk do të doja t'i rezikoj gjërat", kishte deklaruar Rafa pak më parë.

Unitedi planifikon largimin e 6 futbollistëve

Erik ten Hag po planifikon një spastrim të pamëshirshëm këtë verë në fazën e ardhshme të projektit të tij në Manchester United. Aktualisht Unitedi po kalon një formë jo të mirë në kampionat, ndërsa tani i kërcënohet edhe renditja në katër vendet e para. Zgjidhja e trajnerit përpara betejave të fundit të skuadrës së tij duket se do të jetë rifreskim i ekipit në merkaton e verës. "Manchester Evening News" pretendon se lojtarët si Harry Maguire, Alex Telles, Brandon Williams, Dean Henderson, Brandon Williams, Din Henderson dhe Anthony Martial do të nxirren në shitje. Ndërsa trajneri holandez po humbet gjithnjë e më shumë durimin me gjendjen fizike të Jadon Sanchos.



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A.
Kosova Landfill Management Company J.S.C
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8, bazuar në Rregulloren Nr. 23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e vendeve të punës në KMDK SH.A, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe bazuar në Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK SH.A me Nr.41/2023 me nr. të protokollit 02-07/41, KMDK SH.A shpall këtë:

KONKURS PUBLIK (PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS)

Titulli: Udhëheqës i Sektorit të Inxhinierisë 1 (Një) Pozitë

Numri i Referencës: ZP/KJ-7-2023

I raporton: Drejtorit të Operativës

Niveli i pagës: Niveli IV

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të caktuar (1 vit) me mundësi vazhdimi

Vendi i punës: KMDK-së SH.A

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Planifikimet mujore dhe vjetore lidhur me konstruktimin e projekteve për investimet nëpër deponi;
- Harton përshkrimet teknike (me përmasa dhe llogari) të projekteve për rehabilitimin e infrastrukturës së DS dhe mbikëqyrë realizimin e punëve të kontraktuar me palët e treta;
- Planifikimet mujore dhe vjetore lidhur me konstruktimin dhe investimet nëpër deponi;
- Harton planet vjetore për nevojat furnizuese për të gjitha llojet e materialeve të cilat përdoren për infrastrukturën e Deponive Sanitare dhe Stacion të Transferit të cilat janë të nevojshme për operimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e Deponive dhe i dorëzon tek Drejtori i Operativës;
- Përcjellë punën teknike në mirëmbajtje të të gjitha Deponive;
- Monitoron dhe menaxhon me zbatueshmërinë e projekteve kapitale nëpër Deponitë Sanitare dhe Stacion të Transferit,
- Jep këshilla dhe zgjedhje teknike për intervenime të domosdoshme në infrastrukturë, brenda deponive;
- Udhëheqësi i Sektorit të Inxhinierisë menaxhon me Njësinë Teknike dhe Njësinë e Mbrojtjes së Ambientit.
- Udhëheqësi i Sektorit të Inxhinierisë bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me Menaxheret e Deponive dhe Udhëheqësit e Njësisë,
- Udhëheqësi i Sektorit të Inxhinierisë në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Drejtorin e Operativës, bashkërendon aktivitetet operative në Deponitë Sanitare dhe Stacion të Transferit,
- Përgatitë raportet sipas kërkesës së DO, mujore, vjetore etj;
- Udhëheqësi i Sektorit të Inxhinierisë për punën e vet i përgjigjet drejtpërdrejt Drejtorit të Operativës, sipas nevojës edhe Kryeshefit Ekzekutiv

Kualifikimet dhe përvoja e punës:

- Diplomë Universitare, Fakulteti i Ndërtimitarisë dhe Arkitekturës;
- Përvojë pune së paku 2 (dy) vite në fushën përkatëse;

Aftësitë kryesore:

- Shkathësitë të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit, janë të nevojshme programet (Autocad, Archicad, Windows, Outlook, Microsoft Office dhe programe të llogaritjes së strukturës së stabilitetit etj.);
- Kapacitet për punë ekipore;
- Aftësi të mira komunikimi, me palët e interesit;
- Preferohet njohja e gjuhës angleze në të folur dhe të shkruar.

Titulli: Udhëheqës i Njësisë Teknike 1 (Një) Pozitë

Numri i Referencës: ZP/KJ-8-2023

I raporton: Drejtorit të Operativës

Niveli i pagës: Niveli IV

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të caktuar (1 vit) me mundësi vazhdimi

Vendi i punës: KMDK SH.A

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Udhëheqësi i Njësisë Teknike ka për detyrë të bëjë:
- Udhëheqësi i Njësisë menaxhon me stafin teknik duke përfshirë, automekaniket, dhe drejtuesit/manipuluesit e makinerisë së rëndë.
- Planifikimet mujore dhe vjetore lidhur me angazhimin dhe punën e makinerisë së KMDK-së;
- Planifikon mirëmbajtjen dhe servisimin e rregullt të makinerisë duke udhëzuar teknikët dhe ngasësit e makinerisë me qëllim të parandalimit të defekteve;
- Këshillon, inspekton dhe trajnon teknikët dhe ngasësit e makinerisë;
- Harton specifikat teknike për tenderët për makinerinë e rëndë;
- Hulumton tregun për asetet (makineri të rëndë) dhe pjesë rezervë për KMDK-në;
- Bën Inspektimin e rregullt, të makinerisë së KMDK-së;
- Jep mendime profesionale dhe përcakton defektet në makinerinë e KMDK-së;

-Si dhe punë shtesë që i delegohen nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë dhe sipas nevojave të KMDK-së;

-Udhëheqësi i Njësisë Teknike në bashkëpunim me Udhëheqësin e Sektorit të Inxhinierisë si dhe në bashkëpunim me Menaxheret e Deponive bashkërendon aktivitetin për mirëmbajtjen e peshoreve/urë matëseve, pompave të ujit, rezervarët e derivateve, gjeneratorët si dhe të pjesëve të tjera teknike që janë në shërbim të operativës.

-Udhëheqësi i Njësisë Teknike për punën e vet i përgjigjet Drejtorit të Operativës.

Kualifikimet dhe përvoja e punës:

- Diploma universitare, Fakulteti i Makinerisë;
- Minimum 2 vjet përvojë pune për makineri të rëndë;

Aftësitë kryesore:

- Njohuri të dëshmuara në lëmin e riparimit dhe servisimit të makinerisë;
- Njohja e punës me kompjuter duke përfshirë: MS-Office dhe programet tjera relevante sa i përket fushës së makinerisë;
- Njohuri të gjuhëve që janë në përdorim zyrtar në Kosovë, përparësi të jetë njohja e Gjuhës angleze apo Gjermane;
- Aftësi për të prezantuar rezultatet e analizave gjatë punës.

Titulli: Operator teknik i sektorëve dhe urë matës 1 (Një) Pozitë

Numri i Referencës: ZP/KJ-9-2023

I raporton: Përgjegjësi i Deponisë

Niveli i pagës: IX

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të caktuar (1 vit) me mundësi vazhdimi

Vendi i punës: ST-Ferizaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të bëjë pranimin, evidentimin dhe matjen e sasisë së mbeturinave të sjella me mjete transportuese të klientëve dhe të ruaj evidencat e secilës matje;
- Obligohet të përcjellë dhe të bëjë matjen e mjetit transportues si në hyrje edhe në dalje si dhe kujdeset që kur bëhet matja në automjet mos të jetë asnjë punëtor;
- Të mbaj pastër (kontejnerin) zyrën të peshorja;
- Obligohet që të përcjellë të gjitha lëvizjet brenda deponisë;
- Bën kontrollin dhe përcjellë nivelin e ujërave të zeza në lagunë dhe në sektor të mbeturinave;
- Në bazë të udhëzimeve të Përgjegjësit të Deponisë, lëshon pompat për ri qarkullimin e ujërave të zeza;
- Obligohet që të informojë PD për parregullsitë që hasë gjatë kontrollit të deponisë;
- Në bazë të udhëzimeve të PD, bën lëvizjen e gypave ri qarkullues të ujërave të zeza për spërkatje;
- Sipas nevojave dhe kërkesës së PD kryen edhe punë tjera;
- Për punën e vet jep përgjegjësi PD.

Kualifikimet:

- Diploma e shkollës së mesme;

Aftësitë kryesore

- Të ketë aftësi për të komunikuar me palë;
- Të jetë i aftë të punojë në ekip dhe nën presion.

Procedura e konkurrimit:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrat e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A apo ta shkarkojnë nga web faja e internetit në adresën: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në zyrat e Burimeve Njerëzore në adresën: Rruga "Bekim Fehmiu" Nr. 137, 10000 Prishtinë, Kosovë (Afër Shkollës Shtjefën Gjeçovi), Lakrishtë. Tel: 038/ 600 – 552.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedurë të tjera të rekrutimit.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Aplikacioni
- CV,
- Diploma,
- Certifikatat mbi kualifikimet dhe trajnimet,
- Dëshmi mbi përvojën në punë, si dhe dëshmi të tjera në bazë të kualifikimit dhe aftësive.
- Certifikatë nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i/e dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit).

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pa kompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit të Konkursit të Jashtëm në Gazetat/Platformat Elektronike dhe Web-Faqe të KMDK-së, duke filluar nga data: 05.04.2023 deri me datën 19.04.2023 ora 08:00-16:00.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Zyren e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Tel: 038/ 600 – 552.



KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE SKLADIŠTIMA NA KOSOVU dd

Na osnovu Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, Zakon br. 03/L-212 o radu, konkretno član 8, na osnovu Uredbe br. 23/2020 o postupcima zapošljavanja, organizacionoj strukturi, kategorizaciji i opisu poslova u KMDK S.A., na osnovu Administrativnog uputstva (MPMS) br. KMDK SHA sa br. 41/2023 sa br. protokola 02-07/41 KMDK dd saopštava:

JAVNI KONKURS (ZA POPUNJAVANJE RADNIH MJESTA)

Zvanje: - Rukovodilac sektora inženjeringa 1 (jedna) pozicija

Referentni broj: ZP/KJ-7-2023

Izveštava: Direktor operacija

Nivo plata: Nivo IV

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje ugovora: Na određeno (1 godina) sa mogućnošću produženja

Mjesto rada: KMDK dd

Dužnosti i odgovornosti:

- Mjesečno i godišnje planiranje vezano za izgradnju projekata za ulaganja u deponije;
- Izrađuje tehničke opise (sa dimenzijama i proračunima) projekata sanacije infrastrukture DS i vrši nadzor nad izvođenjem radova ugovorenih sa trećim licima;
- Mjesečno i godišnje planiranje izgradnje i ulaganja u deponije;
- Izrađuje godišnje planove potreba za snabdijevanjem svih vrsta materijala koji se koriste za infrastrukturu sanitarnih deponija i transfer stanica neophodnih za rad, održavanje i rad deponija i dostavlja ih direktoru operacija;
- Izvodi tehničke poslove na održavanju svih deponija;
- Prati i upravlja primjenjivošću kapitalnih projekata na sanitarnim deponijama i transfer stanicama,
- Daje savjete i tehničke izbore za neophodne intervencije na infrastrukturi, unutar deponija;
- Rukovodilac Sektora inženjeringa rukovodi sa Tehničkom jedinicom i Jedinicom za zaštitu životne sredine.
- Rukovodilac sektora inženjeringa saraduje i koordinira aktivnosti sa menadžerima skladišta i rukovodiocima jedinica,
- Rukovodilac sektora inženjeringa u direktnoj saradnji sa direktorom operacija koordinira operativnim aktivnostima na sanitarnim deponijama i transfer stanicama,
- Izrada izvještaja prema zahtjevu DO, mjesečne, godišnje i sl.;
- Načelnik sektora za inženjering za svoj rad odgovara direktno direktoru operacija, a po potrebi i glavnom izvršnom direktoru

Kvalifikacije i radno iskustvo

- VSS, Građevinsko-arhitektonski fakultet;
- Radno iskustvo od najmanje 2 (dvije) godine u relevantnoj oblasti;

Ključne vještine

- Odlično poznavanje rada na računaru, neophodni su programi (Autocad, Archicad, Windows, Outlook, Microsoft Office i programi za proračun strukture stabilnosti itd.);
- Kapaciteti za timski rad;
- Dobre komunikacijske vještine sa zainteresovanim stranama;
- Poželjno je poznavanje govornog i pisanog engleskog jezika.

Zvanje: - Rukovodilac tehničke jedinice 1 (jedna) pozicija

Referentni broj: ZP/KJ-8-2023

Izveštava: Direktor operacija

Nivo plata: Nivo IV

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje ugovora: Na određeno (1 godina) sa mogućnošću produženja

Mjesto rada: KMDK dd

Dužnosti i odgovornosti

- Rukovodilac tehničke jedinice odgovoran je za:
- Vođa jedinice upravlja tehničkim osobljem uključujući automehaničare i vozači/operatori teških mašina.
- Mjesečno i godišnje planiranje vezano za angažovanje i rad mehanizacije KMDK-of
- Planira redovno održavanje i servisiranje mašine upućivanjem tehničara i Pogoni strojeva u svrhu sprječavanja kvarova;
- Savjetuje, pregleda i obučava tehničare i vozače mašina;
- Izrađuje tehničke specifikacije za tendere za tešku mehanizaciju;
- Istražuje tržište sredstava (teške mehanizacije) i rezervnih dijelova za KMDK;
- Vršiti redovne preglede mehanizacije KMDK;
- Daje stručna mišljenja i utvrđuje kvarove na mašinama KMDK;
- Kao i dodatni poslovi koje delegira neposredni rukovodilac a prema njegovim potrebama

KMDK;

- Rukovodilac tehničke jedinice u saradnji sa rukovodiocem sektora za inženjering as
- te u saradnji sa upravnicima deponije koordinira aktivnosti održavanja vaga/mjernih mostova, pumpi za vodu, rezervoara derivata, generatora kao i ostali tehnički dijelovi koji su u službi operative.
- Rukovodilac tehničke jedinice za svoj rad odgovara operativnom direktoru.

Kvalifikacije i radno iskustvo

- Fakultetska diploma Mašinskog fakulteta;
- Minimalno 2 godine radnog iskustva za tešku mehanizaciju;

Ključne vještine

- Dokazano znanje iz oblasti popravke i servisiranja mašina;
- Poznavanje rada na računaru uključujući: MS-Office i druge relevantne programe kao što su i pripada oblasti mašina;
- Poznavanje jezika koji su u službenoj upotrebi na Kosovu, poznavanje jezika je prioritet engleski ili njemački;
- Sposobnost prezentovanja rezultata analiza tokom rada.

Zvanje: - Tehnički operater sektora i mjernog mosta 1 (Jedna) Radno mjesto

Referentni broj: ZP/KJ-9-2023

Izveštava: Upravitelj deponije

Nivo plata: IX

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje ugovora: Na određeno (1 godina) sa mogućnošću produženja

Mjesto rada: ST-Ferizaj

Dužnosti i odgovornosti:

- Prihvati, evidentira i izmjeri količinu otpada dovezenog vozilima kupaca i čuva evidenciju o svakom mjerenju;
- dužan je da prati i izmjeri transportno vozilo kako na ulazu tako i na izlazu, kao i da u vrijeme mjerenja nema radnika u vozilu;
- Održavati kancelariju za vaganje (kontejner) čistim;
- dužan je da prati sva kretanja unutar deponije;
- kontroliše i prati nivo otpadnih voda u laguni i sektoru otpada;
- na osnovu uputstava šefa deponije pušta pumpe za recirkulaciju otpadnih voda;
- dužan je obavijestiti UP o svim nepravilnostima na koje se uoče tokom inspekcije deponije;
- Na osnovu uputstava DP-a vrši pomicanje recirkulacijskih kanalizacionih cijevi za prskanje;
- Prema potrebama i zahtjevima DP-a obavlja i druge poslove;
- PD daje odgovornost za svoj rad.

Kvalifikacija

- Srednjoškolska diploma;
- Ključne vještine
- Da ima sposobnost komuniciranja sa strankama;
- Da mogu raditi u timu i pod pritiskom.

Konkursna procedura:

Zainteresovani kandidati mogu dobiti zvanični formular u kancelariji za ljudske resurse KMDK SH.A ili ga preuzeti sa web stranice na adresi: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacija se može dostaviti u fizičkoj kopiji kancelariji za ljudske resurse na adresi: ulica „Bekim Fehmiu“ br. 137, 10000 Prishtina, Kosovo (blizu škole Shtjefën Gjeçovi), Lakrishtë. Telefon: 038/ 600 – 552.

Kandidati koji se takmiče moraju ispravno unijeti adresu, kontakt telefon i email adresu. Samo odabrani kandidati će biti pozvani na dalje procedure zapošljavanja.

Potrebna dokumentacija:

- Aplikacija
- Životopis,
- Diploma,
- certifikate o kvalifikacijama i obuci,
- Dokaz o radnom iskustvu, kao i drugi dokazi na osnovu kvalifikacija i vještina.

- Uvjerenje nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da nije osuđivan za neko krivično djelo (ne starije od 6 (šest) mjeseci od dana izdavanja)

Napomena: Prijave poslate poštom, koje su obilježene poštanskim žigom posljednjeg dana roka za prijavu, smatrat će se valjanim i bit će uzete u obzir ako stignu u roku od tri (3) dana. Prijave koje pristignu nakon ovog roka i one koje nisu kompletirane sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja Eksternog konkursa u novinama/elektronskim platformama i web stranicama KMDK, počev od: 05.04.2023. do 19.04.2023. godine, 08:00-16:00 časova.

Za detaljnije informacije možete se obratiti Službi za ljudske resurse KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Telefon: 038/ 600 – 552.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Lokaj Solar” Sh.p.k Prilep, Deçan, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin fotovoltaik 15.44 MWp (15 ha) në Rastavicë komuna e Deçanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.05.2023 në ora 10:00 në hapësirat Shkollës Fillore “Sylejman Vokshi” kilometri i 5 – të, rruga Deçan – Gjakovë, Fshati Prilep, Komuna Deçan do të organizohet debat publik nga Kompania “Lokaj Solar” Sh.p.k Prilep, Deçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/71925674037?pwd=QvZPneyDVy3xzGjumBb4MYScT3LtsX.1>

Meeting ID: 719 2567 4037

Passcode: 1tn90Q

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “Lokaj Solar” Sh.p.k Prilep, Deçan për impiantin fotovoltaik 15.44 MWp (15 ha) në Rastavicë komuna e Deçanit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vn.m.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Konstantini Holding” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811490143 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Konstantini Holding” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811490143 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Konstantini Holding” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811490143 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Lokaj Solar” Sh.p.k Prilep, Deçan, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin fotovoltaik 33.98 MWp (25 ha) në Prilep komuna e Deçanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.05.2023 në ora 10:30 në hapësirat Shkollës Fillore “Sylejman Vokshi” kilometri i 5 – të, rruga Deçan – Gjakovë, Fshati Prilep, Komuna Deçan do të organizohet debat publik nga Kompania “Lokaj Solar” Sh.p.k Prilep, Deçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/71925674037?pwd=QvZPneyDVy3xzGjumBb4MYScT3LtsX.1>

Meeting ID: 719 2567 4037

Passcode: 1tn90Q

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “Lokaj Solar” Sh.p.k Prilep, Deçan për impiantin fotovoltaik 33.98 MWp (25 ha) në Prilep komuna e Deçanit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Njoftim

Kompania “Swiss Visions AG” Sh.a, me numër te biznesit: 70700670, bënë shuarjen e biznesit.

Kompania “Swiss Visions AG” Sh.a, me numër te biznesit 70700670, i regjistruar me datën 15.10.2010, me seli ne Prishtinë (adresa: Ulpiana P+4/L nr. 5), njofton të gjithë te interesuarit qe po bene mbylljen e aktivitetit te saj biznesor dhe fton te gjithë ata qe kanë kërkesa apo çka do që ka ndaj këtij biznesi të paraqiten gjatë kësaj kohe të shpalljes së këtij njoftimi në media, në numrin e telefonit: 045/217-045!

Thirrje për aplikim

Halim Sinani B.I. – NUI **812016857**, me adresë në fshatin Barilevë, Rruga Mulla Ahmet Çunaku, 60, po kërkon ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/propozim për:

“Ngritje të serës bllok 0.40 ha dhe energji eficiente (panele solare) 3 Kë”

Nr. Prokurimit Prill 01-2023.


Emri: Halim Sinani B.I

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit: halimsinanih@gmail.com

Adresa: Fshatin Barilevë, Rruga Mulla Ahmet Çunaku, 60

Tel: +383 44 837 306

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 15 ditë nga dita e publikimit ne gazetë të thirrjes, **ora 14:00**, në adresën e kompanisë: Fshatin Barilevë, Rruga Mulla Ahmet Çunaku, 60



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Artan Gurgushka shpall te pavlefshme 4 dëftesa, certifikatën , diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Dani Francesk shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Zef Lush - Marku " Velezhe.

Valbon Gashi shpall te pavlefshme dëftesat QK "11 Marsi " Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues